


TOMORRI MAL - DËSHMITAR I GJITHËSISË

Nga prof. Sazan GURI

Tomorri – mal që s’fle

Mali i Tomorit është formuar së paku 65 milion vjet më parë dhe rri e qëndron, ashtu si e shohim apo e prekim sot, qysh të paktën 5-6 milion vjet, shumë më parë se njeriu të çfaqej mbi dhë, sikundër na poetizon i madhi Xhevair Spahiu se: *Atios në det lau këmbët, Tomorri lan sytë, i dyti është i parë, i pari është i dytë.*¹ Kqyrni të dashur lexues, se sa bukur përkojnë fjalët atios me babazotin apo babatomorrin. Nga fjala “at” është ndërtuar ajo “tatë(a)” për ‘baba, gjysh’, që ca syresh si albanologu G.Mayer e marrin për huazim nga turqishtja,² kur siç shihet fjala shqipe “at” qëndron jo rastësisht brenda saj.



Jo rastësisht ngjiz jeta pranë këtij mali, sepse ky Mal i ndërtuar nga sedimente gëlqerore plot ujë e yshyre, dhe i kthyer në shkëmb i gjithëfarëllojshëm ka qenë shumë i përdorshëm në nevoja të njeriut. Prej gjeologëve austriak më 1917 është thënë se ky Mal ka brenda një liqen shumë të madh, prej nga dalin 100 burime uji.³ Por, më e saktë, lidhur me 100 burimet ujore të këtij Mali mbetet referenca prej gjeografit të lashtësisë (studiusit të natyrës) Plinit plaku (Plinius), për të cilin thuhet se i ka numëruar këto burime rreth e qark Tomorrit.⁴ Për rëndësinë e këtij Mali na jep shkurtazi edhe akademiku Rexhep Qosja, kur na thot se: *Mali i Tomorrit është hyjnizuar prej rilindasve, për shkak se ai është dëshmitar i historisë.*⁵ Ndaj, ky është një kult tipik alla pellazg mbi një vend zemër dhe magjik të tyre, dhe siç do e dëftojmë edhe më poshtë nuk ka kult më të vjetër se ky. Ai doli si fryt i një: “Populli të zgjuar të racës njerëzore”. Ndaj dhe poeti popull vë në gojën e këngëtarit të pavdekshmit Demir Zyko profecinë për Baba Tomorrin: *O Tomor, o mal i lartë / Dëshmitar i jetësisë / tregom pak Historinë e Shqipërisë.*



Tomorri Mal - i madhërishtëm apo i magjishëm

¹ Xhevair SPAHIU, poezia “Në majë të malit”,

² G. MAYER, Etimologjia e shqipes, fq. 56, v. 2007

³ Alfred FRASHËRI, Tomorri, Mali i shenjt që ne shqiptarët e quajmë Baba, v. 2015

⁴ PLINI, vol. 18, fq. 2722-2723

⁵ Rexhep QOSJA, Çështja shqiptare: Historia dhe politika, v. 1998

Sigurisht që nuk ka vend në botë të mos ketë male me bukuritë e veta, madje të larta si Alpet e Zvicrës, apo si vargmalet e Afrikës, të Amerikës latine deri në Himalaje, por që shumica e tyre përveç lartësisë, ku njeri më i madh se tjetri nuk të thonë gjë tjetër. Ndryshe nga to, biles shumë ndryshe nga to, pa male të tjerë gjigant e përreth, shtrihet një mal që flet, sepse gjithë prijsat qëmoti para se të shkonin në fushë beteja kërkonin fatin dhe konsultoheshin apo flisnin me këtë mal.


Shtrihet një mal që ngrihet e mbështetet mbi malet e tjerë, si për të thënë, që ju o njerëz, nuk mund të punoni e të jetoni të vetëm.

Shtrihet një mal, që si askënd tjetër në këtë botë lidh kaq mahnitshëm fushat e pamatë të Myzeqesë me kodrat pjellore e t’larta nën re, si për të na thënë që po kaq të lidhur duhet të jeni dhe ju o njerëz. Shtrihet një mal, i cili të habit për befasitë që të krijon, që kur i qasesh nga para (Kavajë, Berat, Kuçovë), ai të



çfaqet sa majtas e sa djathtas, aq tutje e kaq tëhu, herë i plotë dhe herë i fshehur. Dhe kur i del nga pas apo nga anash, (Elbasan, Gramsh, Skrapar, Përmet) të duket sikur e pushton, sepse të lë të ngjitesh e ta rrokësh si fëmija babanë, ndonjëherë të duket, pse ky qenka, si i vogël, por më së shumti i madh. Mal që s’fle, që sipas poetit të asaj ane Pasho Çela: *gdhihet, pa u gdhirë*. Po flasim për një Mal, që mbartte në faqe të vet mijra hektarë me ah e lis, po aq me çajra shërim bërëse (sherebela-shërimbën, që më pas latinët e bën salvia-jetëshëron). Po flasim për një mal që zinte vend në një krahinë, ku sipas Plutarkut që shprehej se para kërdive romake në Berat e në Iliri dhe Epir ishte: një “...vend, ku gjithëka ishte me buri (burrimor-bollëk).” Enzo Gatti, shpesh e thoshte se: “*Priftërinjtë ilirë ishin ekspert astronomë. Ata ndërtonin qendra, ku vëzhgonin qiellin. Parashikonin ndikimin e yjeve, kuptonin ciklet e hënës, ciklet menstruale të grave, baticat dhe zbaticat.*”⁶

Po këtë konsideratë na jep edhe studiusi tjetër amerikan, Robert Temple, kur na sjell në vëmendje faktin se: *Ata, pellazgët, studionin galaktikat, kometat dhe mjegullat dhe i faleshin yllit “Sirio”.*⁷ Këta priftërinjtë kishin aftësi, veç të



tjerave, që të vendosnin kontakte midis të gjallëve dhe të vdekurve dhe ishin në gjendje të shkrinin kufijt realë midis dy botëve, dhe ata merreshin si më të zotët nga të gjithë të tjerët. Ishin këta priftërinjë që sipas historianit Libius.... *u mësuan barinjëve të mbjellin drithëra dhe të linin lëndët e lisave.*⁸

⁶ Enzo GATTI, *Revista Rrënjët*, v.2016

⁷ Robert TEMPLE, *Misteret e Yllit Sirios*, fq. 231, v. 1998

⁸ Tit Livi, *Historia e Romës*,

Madhështia e këtij Mali nuk mund të mos binte në syrin e studiusit dhe piktorit më të madh të shek.-XIX, Eduard Lir, i cili kur kaloi nëpër tokat e Elbasanit ndali enkas dhe thonë se në punë e sipër fliste nën zë e mbi zë se: *Tomorri , ky mal mbretëror, mal si një Sokrat madhështor*⁹

Supersticioni i shqiptarëve për Tomorrin Mal

Së pari, gjetën fron për t’u ulur i madhi Zot (Zeusi) që thuhet se u ul me shikim nga ky Mal që akoma nuk kishte marr emër dhe formoi botën, aq sa thonë se Altarin e parë, Zeusi e pati në trevat e Thesprotisë apo Tomorrisë. Këtë fakt apo legjendë (që në shqip i thonë *gjë e lënë nga të parët*) e mbështet edhe studiysi tepër i njohur Stefan Bizantini, kur shprehet se: *“Dodona, qytet i Molosisë në Epir, ku ndodhet Zeusi i Dodonës, që është i pari në Dodonë”*.¹⁰

Por, edhe ati i gjuhës shqipe, Kostandin Kristoforidhi, qysh para Naimit e Çajupit pohon se: *“te Mali i tomorrit rri Zoti, rri i madhi i jetës, rri ai që ruan shqipërinë....I qofshim falë atij Zoti...Hieja e ati na mbuloftë e na ruajtë. Dhe kur e pyetën Kristoforidhin, se kush i shërben Zotit të Tomorrit, ai vë në gojën e një personazhi tjetër se: “shqipet e malit i shërbejnë, ato janë ëngjëjt e ati prandaj edhe neve na thonë shqipëtarë”*.¹¹ Më vonë, Çajupi shkruan: *Baba Tomorr, kish’e Shqipërisë/Mal i lartë, fron i perëndisë/Tek ti vinë njerëzit qëmoti/për të mësuar se ç’urdhëron Zoti”*.¹² Nëpërmjet Tij, formuan hyjnitë e gjithëpushtetshme si Diellin jetëdhënës, (biri i tij në tokë – jo më kot mashkulli i shtëpisë thirej djalë – diell).



Pastaj, formuan hyjninë mbi *Zjarrin e flakërishëm-anjin* (prej nga erdhi dita e enjte e javës, si dita më e mbarë ku shkëmbehen nishanet e nuses, organizohen mbledhjet, kuvendet, etj.), dhe më pas formuan hyjninë për Kreshtën e lartë të Malit (në dimër) si *Çuka e Peljes*, e njohur sot si Maja e Çukës, ku venë alpinistët dhe një pjesë e pelegrinëve, që ndryshe i thonë ose ka kuptimin *Çuka e Plakës*. Gjithsesi, maja partizani ose *Çuka e Bukur* përfaqëson një pikë (Fig. - 29), ku njerëzit e zonës betohen si rasti "Për atë Çukë". Po pse do thoni ju të dashur lexues? Sepse, kjo pikë apo Çukë, e thirur për 10,000 vjet si Çuka e Zesë, në kuptimin Çuka e Zeusit, meqënëse aty u ul Zoti e nisi të formojë botën, u tradhtua nga vetë shqiptarët, që për t’i bërë qejfin regjimit e njehsuan këtë pikë të Zotit të natyrës me Zotin e shqiptarëve, sepse fare mirë mund të zgjidhnin një pikë tjetër, atë të Abaz Aliut p.sh. Por, jo, i duhesh ajo më e larta ajo e Zotit të gjithëpushtetshëm.



⁹ Eduard LIR, *Udhëtime në Shqipëri*, v. 1848 (<https://malitomorrit.wordpress.com>)

¹⁰ Stefan BIZANTINI,

¹¹ Kostandin KRISTOFORIDHI, *Gjahu i malësorëve, nëntitulli “Hieja e Tomorit”* v. 1884

¹² CAJUPI, *Vjersha “BABA TOMORRI”*, v. 2007

Me të drejtë populli ynë, perëndinë e parë e ka quajtur *Baba-Dielli* dhe Tokën *Nëna-Tokë*. Dhe për shkak se Baba-Dielli, lindte në Tomorr, gjithë treva që e shikonte Tomorrit, si skrapallinj, gramshiotët, kavajasit, pse jo, i gjithë populli ynë, këtë Mal madhështor që “*sillte diell*” në mënyrë intuitive e quante Baba-Tomorri. (fig. 31) Ndaj dhe sot betohen: “*Për atë Diell*” ose “*Për Baba Tomorr*”, dhe ky lloj betimi për njeriun shqiptar, si në agimet e jetës, dhe pothuajse sot nënë ka qenë sinonim i një perëndie - *Perëndisë së Diellit*. Megjithëse, thonë se një gjë e frikshme banon, atje tej në majën e Malit të Tomorrit. Vetëm ata që janë me zemër të pastër mund t’ja turbullojnë vetminë asaj. Ata që nuk janë të pastër, Ai i përzën me kokra breshëri e me erëra të forta, ‘*me të përzieme e me të përçume gjaku të hundevet*’ ose *i bën të mbeten rrugës*.¹³ Shikoni të dashur lexues, kur mijra besimtarë dhe jo besimtarë, me mendje të mbledhur top se atje marrin energji dhe me mendje të dyzuar ose jo të mirë, dhe kapni momentin se si këta të fundit mbesin në mb’udhë. Dhe po deshe, mos beso?! Biles, të vjetrit, prap ajo e lëna-legjenda, thonë se: ‘*Kur të pyet mali i Tomorit, a je mirë - thuaj se jam mirë që të të kthehet me të vërtet mirë*’.

Betimi për Baba Tomorrit

Etnologia angleze Margaret Hasluck, që u ngjit në majë të tij më 1930, konstatoi midis të tjerave se: *pelegrinët besonin në një fuqi të mbinatyrshme me seli në atë majë, e se betimi për Baba Tomorrit ishte më i fortë se betimi mbi Ungjill ose Kur’an*.¹⁴ Edhe Robert Elsie në librin e tij shkruan se Mali është personifikuar si vetë Zoti, ndaj edhe e quajnë “Baba Tomorri”, për të cilin banorët e krahinës betohen “Për Baba Tomorr”.¹⁵ Po edhe një konsull francez në Janinë, Zhyl Dëgran, pasi e kishte vizituar dy herë radhazi, shkruan më 1901, fillimisht mbi thashethemet e bestytnitë, mandej mbi “takimin” me lirin e “shenjtë”: Kësisoj, Mali i Tomorrit e trashëgon vetë emrin e tij, si Mal i Zotit të Pellazgëve. “*O Zot, mbret Dodonas pellazgjik që banon në ato vënde të largëta e sundon mbi Dodonën dimërkeqe...*” shprehet Homeri te Iliada.¹⁶

Tomorri, ky MAL - BABAMAL

Tomorri, MAL - BABAMAL - Mali i të Mirit, Mali i Hie-së, sepse Hie do të thotë Zot në shqip, vend i mirë, vend i shenjtëruar, vend i Hienushëm. Priftërijntë ose fatthënësit, sipas historianëve të lashtë, quheshin *Tomuri*. Fatthënat e tyre quheshin *Tomure*, ndërsa vetë mali quhej *Tomures* ose *Tmaros* - Tomorr? Ndaj, dhe anglisht, e nesërmja quhet *tomorrow*, çfarë të sjellë fati e thëna apo të mirët apo tomurat. Fjalë kjo e marrë qysh nga koha, kur Keltët qendronin bashkë me pellazgët, galët, baskët,

¹³ Viktor BAKILLARI, *Visaret e Skraparit*, v. 2008

¹⁴ Margaret HASLUCK, fq.11-16, *Forum Al.com™* 5/9/15 <http://www.forum-al.com/showthread.php?>

¹⁵ Robert ELISE, 1996, *Historical Dictionary of Albania 2-nd edition*. pdf.

¹⁶ Homeri, *ILIADA*, v. 2006

4,500-5,000 vjet para krishtit, ende pa u shkëputur nga njeri tjetri. Të vertetuara katërcipërisht theksojmë se fjalët ‘Tomure’ e ‘Tomuri’ janë fjalët shqipe - Të mirat e të mirët, prej të cilave ka marrë emrin që në kohë stërgjyshore Tomorri, d.m.th. mal’ i të mirëve ose i të mirave. Edhe sepse, Selija (froni) e perëndive të vjetra që zbrisnin mbi të në mest të reve a mjegullës për të biseduar mbi punërat e njerëzvet e të botës. Prej këtyre fjalëve ka rrjedhur emri Tomuriasë që tregon krahinën e malit Tomor, të quajtur Tomoricë dhe vendasit e saj Tomoricarë’.

Është ky Mal, që sipas studimeve të NASËS sot, shërben si pikë çernier për mbajtjen dhe lëvizjen e botës, duke ofruar një gravitet apo forcë rëndese për tokën si planet më vete, ndoshta për rolin që ai ka në qendër të botës, ndoshta për densitetin e shkëmbinjëve që ai mbart, ndoshta për volumin dhe thellësinë e shkëmbinjëve që ai ka, etj., si këto. Mos u habit i dashur lexues, por një gjeolog e kupton më së miri dhe mund të bëjë lidhje të kësi gjërave. Këto që bota sot i zbulon me shkencë, njeriu parak i ka zbuluar qëmoti me metodat e veta, sepse jo më kot, më sipër thamë se për 3000 vjet (nga viti 12,000 deri në 9000 vjet para krishtit) pellazgët apo para ilirët studiuan galaktikat, ligjet e natyrës. Mit’had Frashëri, duke iu referuar Herodotit thekson se perëndia e Dodonës ishte Jupiteri pellazgjik.¹⁷ Zeusi, i cili respektohej së bashku me të shoqen Dionën, për nder të së cilës festoheshin dy festa, si Dionset e Mëdha edhe Dionset e Vogla. Autorët e antikitetit pohojnë se pyetjes përse je këtu? Zeusi i përgjigjet: Për të ruajtur gruan time Dionsen, ndaj dhe për nder të saj organizoheshin festat e ushyreve (nga datat 7 gusht deri më 14 gusht), me kulm 15 gushtin. Por, begatitë dhe bukuritë e malit të Tomorrit kanë mahnitur edhe përshkruesin me famë, kronistin turk Evelat Çelebiun në vitin 1670, kur vizitoi Beratin. Ndër të tjera, ky na shkruan: *Në këtë Mal ka lloje lloje bimësh barnash e drurësh. Këtu vijnë dijetarë dhe specialistë frëng e zotëri të tjerë, të cilët mbledhin me mijëra barna mjeksore. Me këto shërojnë të sëmurët në vëndet e veta. Këto maja janë rezervuar për shejtorët, por edhe për njerëz të mirë që kanë guxuar të ngjiten gjer atje.*¹⁸

TOMORRI, NGA KULT FATDHËNËS NË SHKËMB I GJAKOSUR

Tomorri, shkëmb i gjakosur apo njerëz të marrosur

Gjithsesi, Tomorri dhe Dodona flenë ende në dhë. Shqetësimi është sesi mund të lihet tërësisht në harresë një zbulim aq i madh e i rëndësishëm për historinë e lashtë, le të themi të Greqisë dhe të krejt Europës?! Sepse ata e dinë shumë mirë që Dodona dhe Tomorri janë pazgjidhmërisht të lidhur me historinë e para shqiptarëve, sikundër e dinë që nuk është aspak histori greke. Këtë pohonte drejtori i shkollës më 1934, i cili ulet dhe shkruan për Dodonën Pellazgjike, duke krijuar një paralelizëm me

¹⁷ Mithad Bej FRASHËRI, *Fati i Shqiptarëve*, v. 2009

¹⁸ Evelat CELEBIU, *Libri i Udhëtimeve*, v. 1670, përmendur nga Perikli Ikonimi, te libri mbi Dodonën dhe Tomorrin, v.1934

lidhjen e malit të Olimp të dhe me historinë e Greqisë së Vjetër¹⁹, Ndaj, shkencëtari i njohur francez Charl Pikar (1882-1965) e ngriti aq sa mundi më 1943, tërë zërin e vet, duke na thënë se: *“Dodona, e vetmja qendër... së cilës nuk i është kushtuar ende një gërmim shterës...”*²⁰

Kjo përbën atë që quhet shkatërrimi final, ku asnjë prej akademikëve tanë ose asnjë prej shtetarëve tanë nuk kujtohen që të paktën të kryejnë detyrën ndaj kësaj zonje (Dodona) plot nur dhe ndaj këtij zoti (Tomorri) plot e përplot hie. Kuptoj pse Helenët nuk e donin, as Tomorin e as Dodonën?! Sepse historia fillon me ta duke patur Olimpin dhe Delfin. Kuptoj pse Romakët e anashkaluan, sepse iu duhesh të shkruanin historinë nga e para. Kuptoj pse Bizanti orthodoks nuk e donte, për shkak të kodeve të paracaktuara për shqiptarët nëpërmjet Dodonës, ndaj edhe e la në harresë. Kuptoj pse Turkomani nuk të linte të gërmoje, për shkak se dilte artifakti shqiptonjë në emblemën e flamurit shqiptar. Kuptoj pse europianët nuk paraprijnë me arkeologji në këtë trevë, sepse iu dilte simboli i Lisit, të cilën ata e kanë pasur perëndi, (*perëndia Druide deri në në fund të mesjetës*), por edhe se iu vjen turp nga ato që kanë molepsur për këtë vend. Kuptoj historianët dhe arkeologët tanë që nuk mund të gërmojnë, sepse duhet të marrin leje prej akademikëve grek e serb, se ndryshe nuk do ta linin vendin me rrëmime deri në pesë përqind të thellësisë, aq sa del shtresë e civilizimeve helene e romake.



Por, ajo që nuk kuptoj dot është sesi një grup i madh peligrinësh, çdo 20-25 gusht, populli i rretheve të Tomorrit dhe besimtarëve bektashinj nga gjithë Shqipëria ngjiten në Kulmak dhe në Majën e Çukës për të bërë kurbanet e zakonshme (fig. 43), dhe venë në këtë trevë, jo për hatër të Baba Tomorrit, që iu ka hapur portën për të paktën 10,000 vjet, qysh kur dolën nga shpellat e Vlushës (aty ku nuk shikonin s’pe-shpell), por për hatër të Abaz –Aliut qysh 300-400 vjet.²¹ Gjithsesi, nuk kuptoj dot si mund këta njerëz “modern” të besojnë se aty ndodhet varri i Ali Aliut, dhe jo varri i Zeusit dhe tanë këtë pelegrinazh e bëjnë në emër të trimit martir të Qerebelasë, dhe jo të të Madhit të gjithë dynjasë. E vërtetë është se edhe “Shpella e Tëmirave” ka qenë një faltore e lashtë, deri nga fundi i vitit 1967, pikërisht aty ku prehet grushti me hi apo me dhë të Abaz Aliut. Shpesh, ky popull, - thoshte i madhi Sami Frashëri - nuk di se çka nën këmbët e veta.

Vazhdoj gjene të mos i kuptoj këta pelegrinë (skrapallinj e mendjellinj) për aq kohë sa nuk dinë pse shkojnë, dhe në vend se të bëjnë kurban një apo dy desh si të parët tanë, therin e shqyejnë mbi 4500 të tillë, me demek zengjinë të rinj. Në një kohë që riti kurban i të parëve tanë ka pasë qenë, që fillimisht

¹⁹ Perikli Ikonomi, *Historia e Tomorrit, Dodona Pellazgjike dhe Tomor’ i Zotit të Pelazgëve, ribotimi, fq. 7; bot. 1934, fq. -5)*

²⁰ *Sharl Pikar*

²¹ *Moikom Zeqo, v. 2007, Shpellat një Shqipëri ende e pazbuluar. Gazeta Shqip, (2007-10-11).*

<https://www.shqiperia.com/Shpellat-nje-Shqiperi-ende-e-pazbuluar.2531/>

mbreti për të pastruar mëkatet e fisit të vet flijonte djalin ose vajzën e vet. Mandej, kur u zbulua se me anë të mëlçisë së deles mund të flisje për gjynahet e njeriut, filloi e u bë kurban një apo dy kokë bagëtie, ku Mbreti kryesonte ceremonitë e fljimeve që pellazgët bënë për nder të perëndive, me qëllim që njerëzit të pastroheshin nga mëkatet. (fig. 44) Mbreti ulej në një stol me tri këmb, në të cilin besohej se ulej edhe orakulli për të marrë e interpretuar më mirë mesazhet nga perëndia. Ndaj, edhe ky rregull u bë pjesë e riteve, si kristiane dhe te ato muhamedane. Nuk arrij të kuptoj, se si një festë mijërvjeçare, ku në vend se të kujtojmë apo të kthehemi te arsyja e të parëve, pse heronjt si Akili, Odhiseja, Aleksandri i Madh, Pirro Burri, Skënderbeu, fjaloseshin me këtë Mal, ndërsa ne vemi dhe me mina e godasim këtë BabaMal (*karriera të shumta sipërfaqësore*). Dihet nga të gjithë tashmë se Homeri te Odiseja, shkruan për heroin e udhëtimit Odhisenë se: “kur po kthehej në udhëtimin e tij të gjatë dëgjoi nga lisi i gjatë fallxhor mendimin e Zeusit”.²²

ARSYEJA E TË PARËVE

Nuk e kuptoj dot, sesi këta njerëz kanë harruar arsyen e të parëve të vet që ngjiteshin në Tomorr më 15 gusht dhe jo më 20-25 gusht. Që ngjiteshin në këtë Mal për të festuar, jo festën prej 400 vjetëve të Abaz Alisë, por për festën prej 12,000 vjetëve të Tomorr pellazgjisë, sepse në Tomor, qysh 12,000 vjet më parë festohej historikisht festa e Nalos, Zeusit, zotit të DODONËS në kujtim të ditës së shpëtimit prej përmbytjes së madhe, e thirur si në zanafillë festa e Noes, duke iu ngjitur Malit, si i ikur nga dukuria e tmershme e natyrës. Së paku, këta pelegrinë le të venë për festën prej 2000 vjetëve të Shën Mërisë, sepse institucionet fetare, qysh në krye të herës, si ajo krishtere e më vonë ajo Bektashiane, s'bën gjë tjetër, veçse kthyen festat e natyrës të shpikura me plot nur nga parakët në festa të kohës së besimit përkatës. As krishterët, e as synitë, nuk do dinin të festonin ditët e zairesë së 7-15 gushtit, nëse kjo festë, që na identifikon me popullin parak tonin dhe atë european, nuk vinte nga thellësitë e mijëvjeçarëve. Mund të theksojmë se ziarreti apo festa e zajreve e yshyreve organizohesh e bëhesh ndër pellazgët apo selët (suliotët e sotëm) e kësaj krahine nga data 07-15 gusht, me kulm diku aty nga data 10 gusht, prej të cilave u morr



²² Homeri, ODISEA, te libri XIX, vargu 290, v. 1973

nga kristianët dhe u emblemua festa e shën Marisë më 15 Gusht,²³ por që synitët bektashinj për ta bënë të tyren e çuan më 20 deri 25 gusht. Po t’i pyesësh këta të fundit, se çfarë është kjo festë nuk të thonë gjë. Po mirë ata, po ky popull, aq memorje të vockël na paska? Kjo është se ç’është?! Për datën 15 gusht si festë e Tomorrit e thotë prerazi edhe i madhi Ekrem Bej Vlora në librin me titull “Aus Berat und vom Tomorr” (nga Berati në Tomorr e kthim), i cili e cilëson si ditë, ku të krishterët i ngjiten malit për t’u falur Shën Mërisë.²⁴ Po në fakt, ngjitja e malit e ka zanafillën qysh 12,000 vjet më parë, ku njeriu parak i hipi këtij mali për të shpëtuar kokën nga përmytjet e fillimit të ngrohjes globale, ku niveli i detit në botë u rrit me mbi 120m.²⁵

Me një fjalë, këta pelegrinë harrojnë atë çfarë thuhet me shumicë në librat e historisë e të gjeografisë, se njerëzit ngjiteshin në këtë mal, jo për ha ha ha e tra la la, por për të respektuar kodet që iu ishin ngarkuar këtij Mali dhe tempullit të vet, si ajo që njerëzit ngjiteshin në majë të malit në kujtim të kohës së tërheqjes së ujërave, nëpërmjet së çarës së malit, pas përmytjes së madhe, që d.t.th. nëse ti o njeri do të tallesh me ujrë e lumenjë, të deteve dhe oqeanëve, dhe nëse ato fryhen, si nga gabimet e tua apo kapriçiot e natyrës, është ky BabaMal, siç e poeton kaq ëmbël poeti ynë i madh, Xh.Spahiu që kokën të shpëton. Madje, ndër faktet enigmatike ka edhe një të jetuar kohët e fundit, sa magjike aq edhe i vërtetë, kur sheh me sytë e tu se çfarë bën një gjë e gjallë kur kalon në satërin e gjakatarit njeri. Një plak i urtë takon një grup shefash të policisë së zonës përreth Tomorrit dhe i pyet se ku po shkoni o djema, me që njihte njërin prej tyre. Atje xhaxha të therim ndonjë dash. Po pse për të therur vihet atje - iu gjegj xhaxhai. Nuk ta shpjegoj dot të tërën e atij Mali – vazhdon i urti t’ju thoj shefave “pak” si barkderra (me fal o miku im, shef B...., se vetë ma ke treguar – por kur të therni delen apo dashin, shikojeni sesi ajo do të kthejë kokën, si për t’u falur Majës së Tomorrit (*Çukës së Peljes dhe jo Çukës së Abaz Aliut*), duke i kërkuar ndihmë për mëkatet tuaja. Dhe ashtu me të vërtetë “të betohem për kuran e qerim” bëri deleja para se të jepte shpirt. U drejtua me fytyrë nga maja e Çukës dhe pastaj ra e përdhosur dhe e gjakosur. Kush të dojë le ta spjegojë, sa fakt, sa enigmë, sa dhe paradigmë.

MËSIME PËR TË MËSUAR

Si përfundim, Mali i Tomorrit së bashku me hien e lënë të Dodonës që në supe mbart, nuk është i sotshëm, e as i djeshëm, e as i kohës së historisë së shkruar, por Mal shumë para historisë, që me shpellat e veta (Vlusha), mbas i gjeti vend pëllumbave dhe ariut, futi dhe mbujti njeriun. Ai është baza

²³ Akademiku J. Bulo shkruan “Këtë nuk e dëshmon vetëm tradita gojore për ekzistencën e Kishës së Shën Mërisë në mal të Tomorrit dhe për pelegrinazhin e besimtarëve ortodoksë më 15 gusht, ditën e Shën Mërisë së gushtit. Edhe në maja të tjera, në veri, në qendër dhe në jug të Shqipërisë, si në majën e Gjallicës e të Pashtrikut, në Shën Llesh të Krujës dhe në majën e Këndrevicës së Kurveleshit, pelegrinët e krishterë festojnë po në mes të gushtit festën e Shën Mërisë” [5].

²⁴ Ekrem Bej Vlora, *Kujtime (1885- 1925)*, përkthyer nga Afrim Koci, botuar në 1972 në Mynih.

²⁵ Sazan Guri, *Stratigrafia Sekuenciale*, fq 77, v.2012

e historisë së njeriut parak pellazg apo European. Ai është themeli i jetës në tokë. Ai është kulti i ngjizjes së shpirtit të njeriut shqiptar. Ai është Mali, ku njeriu shqiptar mori misionin nga Zoti për të shpërhapur farën me protoplazma anembanë Europës. Mal që mirëpret këdo, që bekon këdo që mendon drejt për këdo që edhe mendon drejt. Mal, sikundër thotë studiuesi plot zell Viktor Bakillari, *që godet me rrufenë dhe stocenin e vet, këdo që mendon e vepron mbrapsht*. Ndaj, ai me madhështinë e vet, mjafton ta cekësh nga larg, ai duket se të theret bujrrëm në bukurinë time pagane dhe marrshni bekimin tim si Baba Tomorr dhe jo si ndonjë baba tjetër. Amin. Këto gojëdhëna përfocohen edhe nga të tjera si p.sh kur frynë erë e fortë banorët thonë: *Është zemëruar Tomorri, nga se jemi bërë gjytnaqarë*. Por, më parë ne mblidhemi për t'i dhënë fjalën njeri tjetrit, se çfarë duhet të bëjmë ne për këtë trevë, çfarë mund t'i japim ne nga vetja kësaj treve, dikush me laps, dikush me mendje, dikush me vjersha, dikush me vreshta, sepse nuk është ai, Tomorri, apo ajo treva rreth tij që ka nevojë për ne, por jemi ne që kemi nevojë për të. Por, mbi të gjitha janë fëmijët tanë që kanë nevojë për Tomorrin, për kodrat e tij, për peligrinazhet e tij, fushat në këmbët e tij. Dhe kjo nevojë e tyre është e pakta detyrim që ne i kemi brezit pasues, duke iu lënë një mjedis të natyrshëm.

Është ky mal, si asnjë tjetër në botë, që lidh kaq mahnitshëm fushat e pamatë të myzeqesë me kodrat me plantacione të ullishteve, vreshtave e firqe, si për të thënë që po me kaq kohezion duhet të jeni dhe ju o njerëz. Ndaj edhe poeti Xhevahir Spahiu e barazon Baba Tomorrin me malin e bashkimit dhe të besimit të shqiptarëve. Është ky Mal, si askund tjetër në botë, që të bën të shquash në ditë të kthjellët tanë territorin e banuar nga parakët shqiptarë, filluar nga Ararati në këmbë të Kaukazit e deri në Apeniniet e Baskëve apo Galinë e Francës, si për të thënë që bashkëpunimi me botën është pjesë e genit shqiptar mijëvjeçar. Por, njerëzia e kësaj treve nuk do të jetë për të përçarur këto vise e visare, por edhe për të ndalur dorën barbare, duartë kundër këtyre vlerave që sikur të ishin të gjata, edhe Hënën do të shkatërronin. Pamjet me gurë nëpër rrugët e Skraparit, pamjet e mjera të malit të rrjepur, pamjet me kullota e pyje, që na ishin njëherë, na shtynë të mos flemë, por të zgjohemi, e as mos të ecim, por të vrapojmë në mbrojtje të tyre. Kjo do jetë dhe një nga sfidat, ku ne do të na duhet të ndeshemi, duke pasur luksin, jo për t'u qarë e për t'u ankuar, por për ta zgjidhur. Secili nga ne nuk do të luftojë për mision personal, por për personalitetin Tomorr Mal të luftojë si misionar. Edhe dëgjo këtu ti cicëron apo ti akademik, apo ti fshatar apo ti qytetar apo ti peligrinator, që nuk doni t'ja dini për këtë Mal se ne jemi këtu pranë këtij Mali, që kur na krijoi Zoti. Se ndryshe, do vimë te vargu i të pavdekshmit nga kjo anë, kur thot se: *Reja u var, mali s'duket më, fusha ngel pazot e pazë*.²⁶

²⁶ Xhevahir SPAHIU